REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 499 Prot

Maliq, më 02.02.2026

VENDIM
Nr. 19, datë 30.01.2026

"Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë Maliq"

Bazuar në ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen vendore* "i ndryshuar; neni 8, pika 2,neni 9, pika1, nënpika 1.1, gërma "b", neni 64 "*Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë*"pika "c" ligj nr. 57/2020 "*Për pyjet*"; ligji nr.9693 datë 19.03.2007 "Për fondin Kullosor" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.433 datë 8.6.2016 "*Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike...*", i ndryshuar; Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 299 datë 04.10.2022 "*Për miratimin e planeve të mbarështimit të ekonomive pyjore të Bashkia Maliq*"; Udhëzimi nr.1, datë 09.06.2016 i Ministrit të Mjedisit "*Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 559 datë 29.07.2022 "*Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor*"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.467 datë 31.07.2025 "*Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje, për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme*"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 20 m² në ngastrën nr.39c të Ekonomisë Pyjore Moglicë, Fshati Gurshqipe, Njësia Administrative Moglicë, Bashkia Maliq, me qëllim ngritjen e një Antene Telefonike nga kompania Vodafone Albania sh.a.
2. Ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave për fillimin e procedurave për hartimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe 20 m² me objekt ngritjen e Antenës Telefonike.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi Bashkia Maliq nxjerr certifikatat e pronësisë të ngastrave që do jepen në përdorim dhe lidh kontratën e qirasë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore"* i ndryshuar.

Miratuar me 22 vota
Vota Pro 22
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.02.2026

KRYETARI I KËSHILLIT
Ornildi DEMOLLARI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ